

# Interreg - IPA CBC

Italy - Albania - Montenegro



EUROPEAN UNION

## SMART ADRIA

Europe House 11 dhe 12 Maj  
2023

Në kuadër të projektit

INTERREG SMART ADRIA BLUE GROWTH

Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri

Ju fton të merrni pjesë në:

## WORKSHOP

EKONOMIA BLU: MUNDËSITË DHE SFIDAT  
NË SHQIPËRI



## Prezantimi i Projektit

Ky aktivitet realizohet në kuadër të Projektit ndërterritorial “SMART ADRIA Blue Growth”, mbështetur nga Programi INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi, bashkëfinancuar nga fondet e BE-së, implementuar nga partnerë italianë, malazezë dhe shqiptarë. Projekti Smart Adria synon të promovojë zhvillimin ekonomik, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të intensifikojë bashkëpunimin në zonën e ulët të Adriatikut, me ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta midis aktorëve të sektorit publik dhe privat, në nivel kombëtar dhe rajonal.

## Objektivi i Workshop-it

Ekonomia blu në Shqipëri ka potencial të madh për zhvillim. Bregdeti Shqiptar ofron mundësi të rëndësishme për transportin e mallrave ose/dhe udhëtarëve. Rajoni tërheq një numër të madh turistësh duke e bërë sektorin e turizmit shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Për më tepër zona është gjithashtu një terren i pasur peshkimi dhe përmban pika të nxehta për biodiversitetin, me shumë zona të mbrojtura detare.

Ndryshimet klimatike, rritja dhe plakja e popullsisë, dhe migrimi janë ndër sfidat kryesore ekonomike dhe shoqërore të përforcuara më tej nga fenomeni i globalizimit. Në fokus të politikave dhe strategjive kombëtare hartuara në dekadën e fundit ka qenë promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në sektorët respektivë, duke përfshirë edhe sektorët e ekonomisë blu. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm blu për të ruajtur ekosistemet dhe biodiversitetin duke përforcuar njëkohësisht rritjen e sektorit është një objektiv i rëndësishëm që kërkon njohje të mirë të lidhjeve mes ekonomisë, mjedisit dhe shoqërisë dhe potencialit që gjenerohet nga kjo lidhje.

Ky Workshop ka si objektiv trajtimin teorik dhe zbatimin praktik të koncepteve që lidhin zhvillimin e qëndrueshëm me ekonominë blu, duke adresuar veçanërisht sfidat e mundësitë e sektorit. Kombinimi i seksioneve teorike me ato praktike do t'i shërbejë realizimit të këtij objektivi dhe ofrimit të një përvojë të pëlqyeshme për pjesëmarrësit.

## Përmbajtja e Workshop-it

Workshopi do të zhvillohet në një hapësirë kohore 2 ditore. Në përmbajtje të workshopit do të kombinohen teoria me seksionet praktike, ku pjesëmarrësit do të nxiten të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë produktet e tyre në formën e prezantimeve, rasteve të studimit, shembujve dhe përvojave. Disa seksione të workshopit do të kenë synim t'u ofrojnë pjesëmarrësve njohuri praktike mbi mënyrat e menaxhimit të biznesit të tyre dhe të financimit të tij, për të rritur dhe shfrytëzuar të gjitha mundësitë ekzistuese në treg që përforcojnë potencialin e bizneseve. Në total ofrohen:

- **10 seksione teorike** të shoqëruara nga **webinar-e**
- **Paketa e workshopit që përfshin** slide, video, dhe literaturën e rekomanduar

Pjesëmarrësit në këtë Workshop do të kenë mundësi të përfitojnë nga ekspertiza e lektorëve tanë për të kuptuar më në detaje karakteristikat, mundësitë dhe sfidat e sektorit ku ata operojnë.

Pjesëmarrja në trajnim do të mundësojë:

- plotësimin e njohurive teorike mbi komponentët e ekonomisë blu dhe lidhjen mes ekonomisë blu, vlerave mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat do të krijojnë për pjesëmarrësit një botëkuptim më të mirë mbi punët e tyre dhe mundësitë që linden prej sektorit, duke shfrytëzuar konceptet e ekonomisë qarkulluese;
- njohjen me mundësitë më të mira për financimin e biznesit të tyre duke shfrytëzuar skemat ekzistuese të financimit, teknologjinë e informacionit dhe mundësitë e tjera që përdoren në botë për të arritur financimin e qëndrueshëm;
- njohjen me mundësitë më të mira për promovimin e biznesit të tyre duke shfrytëzuar konceptet e marketingut digjital;
- krijimin e aftësive dhe njohurive për t'u rimëkëmbur pas krizave të natyrave të ndryshme, me fokus të veçantë krizën e Covid-19;
- njohjen e mënyrave të menaxhimit të biznesit të tyre, me fokus të veçantë menaxhimin financiar;
- bashkëpunimin me pjesëmarrësit e tjerë për të përforcuar komunikimin mes pjesëmarrësve në sektor dhe palëve të tjera të interesit.

Kombinimi i pjesëmarrësve, organizatorëve dhe trajnuesve do të kontribuojë në zbatimin e modelit Quadruple Helix, duke siguruar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojave mes anëtarëve të biznesit, akademisë, shoqërisë civile dhe qeverisë.

## PROGRAMI

*E enjte 11 maj 2023*

### **Seminari i parë**

#### **Një vështrim i përgjithshëm i Ekonomisë Blu**

9:00-9:30	<i><b>Regjistrim dhe kafe</b></i>
9:30-10:00	Hyrje në Ekonominë Blu ( <i>Donald Vullnetari</i> )
10:00-10:30	Mjedisi dhe Ekonomia - Prezantimi i Ekonomisë Qarkulluese ( <i>Elona Pojani</i> )
10.30- 11.00	<i><b>Pushim Kafeje</b></i>
11:00 – 11:30	Shërbimet e Ekosistemit dhe vlerat mjedisore ( <i>Perseta Grabova</i> )

11:30-12:30	Mundësitë për zhvillimin e ekonomisë blu, Biznesi në Shqipëri (Emirjeta Adhami)
12:30- 13:30	Punë në Grupe (Moderatore- Emirjeta Adhami)
13.30	<b><i>Dreka</i></b>

---

*E premte 12 maj 2023*

## **Seminari i dytë**

### **Rritja e Bizneseve të Ekonomisë Blu në Shqipëri**

9:00- 9:30	<b><i>Regjistrim dhe kafe</i></b>
9:30-10:30	Strategjia e Marketingut dhe e Markimit për rritjen e Ekonomisë Blu në Rajonin Adriatik - Marketingu i Medias Sociale (Matilda Naço)
10:30-11:15	Punë në Grupe (Moderatore- Matilda Naço)
11:15–11:30	<b><i>Pushim Kafeje</i></b>
11:30-12:00	Sigurimi i qëndrueshmërisë/rezistencës për NVM-të në Ekonominë Blu dhe mundësitë e financimit për NVM -të në ekonominë Blu (Perseta Grabova dhe Elona Pojani)
12:00–13:00	Përdorimi i TIK -ut për të nxitur zhvillimin dhe zhvillimin në NVM -të (Kreshnik Skënderi)
13.00-14:00	<b><i>Dreka</i></b>
14:00- 15:00	Menaxhimi Financiar për Sipërmarrësin e Vogël dhe të Mesëm (Rezarta Perri)
15:00-15:15	Pushim Kafeje
15:15-16:15	Punë në grupe (Moderator- Rezarta Perri)